

Studimet letrare në proces: teza, projekte, ide dhe rezultate

VALBONA GAÇE AVDULLAJ

SHËMBËLLTYRA E MARIA MAGDALENËS BIBLIKE NË FIGURËN E GRUAS-PROSTITUTË NË VEPRËN E MIGJENIT

HYRJE

Protagonisti i Biblës, Krishti fliste me shëmbëlltyra.¹ Nuk ishte ai që i shpiku shëmbëlltyrat, ato vinin prej traditës, vetëm se ai i përdori në mënyrë të atillë sa krijoi një identitet të vetin. Nëse do të shfletonim ungjijtë biblikë, do të dallonim pa shumë mundim se e gjithë doktrina e Krishtit është përmbledhur në predikime në formën e historive të shkurtra, atë të shëmbëlltyrave. Domethënia e shumicës së shëmbëlltyrave nuk është e dukshme dhe as që duhet të jetë e tillë. Nëse supozojmë për atë që Krishti është duke folur drejtpërdrejt, atëherë do të jemi duke humbur çështjen kryesore. Është vetë Krishti që pohon se ka zgjedhur këtë ligjërim duke mos pritur që ta kuptonin të gjithë. Studiuesi Shaban Sinani ka vërejtur se letërsia e Migjenit implikohet prej tekstit biblik në nivelin e pragmatikës, kryesisht përmes modelit të shëmbëlltyrave. Kështu, ne mendojmë se shfrytëzimi i një apo disa koncepteve prej shëmbëlltyrave biblike, kryesisht të Krishtit, përdorimi i një koncepti themelor të religjionit të krishterë dhe ndërthurja e tij me disa nocione të tjera të krishtera që më shumë janë plotësuese, pavarësisht koherencës kronologjike, i kanë shërbyer Migjenit në krijimin e shëmbëlltyrave të reja, të cilat, të ndërthurura edhe me koncepte të tjera të mendimit modern sjellin një tekst me një dimension ndryshe nga ai burimor. Maria Magdalena është një prej shëmbëlltyrave që Migjeni ka shfrytëzuar në letërsinë e tij, e cila reflektohet në figurën e gruas-prostitutë dhe shndërrohet në një shëmbëlltyrë të re që i kundërvihet asaj të ligjërimit të krishterë, si pjesë e projeksionit të vetëdijshëm të autorit tonë në lidhjen e ndërlikuar intertekstuale me referencën biblike.

Fjalët çelës: shëmbëlltyrë, ligjërim biblik, prostitucion i shenjtëruar, tension ironik.

Kush është Maria Magdalena në tekstin biblik?

Përfytyrimi i Maria Magdalenës na vjen prej tekstit biblik ku, në fillim e prezanton si një grua mëkatore, e cila shfrytëzoi rastin në një prej herëve kur Krishtin e kanë ftuar në një darkë dhe çoi një enë alabastri plot me vaj erëkëndshëm. *“Dhe duke qëndruar prapa, te këmbët e tij dhe duke qarë, filloi t’ia lajë me lotë këmbët dhe t’ia fshijë me flokët e kokës së saj; dhe t’ia puthte dhe t’ia*

¹ Jezusi ua tha turmave të gjitha këto gjëra në shëmbëlltyra dhe u fliste atyre vetëm në shëmbëlltyra që të përmbushej ç’ishte thënë përmes profetit: “Unë do të hap gojën time në shëmbëlltyra dhe do të zbuloj gjëra të fshehura që nga themelimi i botës” Shih Bibla, Ungjilli sipas Mateut 13:34-35.

vajoste me vaj erëkëndshëm”². Pasi reagimi i të pranishmëve nuk ishte pozitiv, madje të skandalizuar si Krishti e pranoi një “ofertë” të tillë: “Nëse ky do të ishte një profet, do ta dinte çfarë lloj njeriu është gruaja që po e prek, sepse ajo është një mëkatore”, Krishti tregon një shëmbëlltyrë mbi faljen duke e konkluduar:

Prandaj unë po ju them se mëkatet e saj të shumta i janë falur, sepse ka dashur shumë;.... Pastaj i tha asaj: “Mëkatet e tua të janë falur”... Por Jezusi i tha asaj gruaje: “Besimi yt të shpëtoi; shko në paqe!”³

Pas këtij veprimi, që duket se ka qenë jetëndryshues, këtë grua e shohim të na shfaqet në Bibël si një prej grave, që i shërbenin Krishtit: [...] me të [Krishtin] ishin të dymbëdhjetë, dhe disa gra, [...] Maria, e quajtur Magdalenë⁴. Gjithashtu gjatë kryqëzimit dhe varrimit: Aty ishin gjithashtu edhe gra, që shikonin nga larg, midis tyre ishte Maria Magdalena [...] Maria Magdalena dhe Maria, nëna e Joses vërenin ku e vunë.⁵ Prania e kësaj gruaje shfaqet në momentin kyç të ringjalljes duke u bërë dëshmitarja e parë e kësaj ngjarjeje” Si kaloi e shtuna Maria Magdalena dhe Maria, nëna e Jakobit dhe Salomeja, blenë aroma për të shkuar të vajosin Jezusin. Në mëngjesin e ditës së parë të javës, shumë herët, ato erdhën te varri, kur po lindte dielli. Dhe thoshin mes tyre: ‘Kush do të na e rrokullisë gurin te hyrja e varrit?’ [...] Tani Jezusi, pasi ishte ringjallur mëngjesin e ditës së parë të javës, iu shfaq së pari Maria Magdalenës.⁶

Për të kuptuar si përthyeret rrugëtimi i kësaj figure në tekstin migjenian na duhet të ndalemi edhe te cilësia e hershme e këtij personazhi, që lidhet me konceptin “prostitutë-mëkatore”, një koncept, jo thjesht i një veprimi çnderues, ashtu si mund ta rrokim ne sot kuptimin, por me kuptimet e mbartura nga kultura e lashtë hebreje dhe ndikimet e kulturave të tjera fqinje.

Në tekstin biblik të Testamentit të Vjetër janë të pranishme dy koncepte për të përshkruar fjalën prostitutë: *zonah*, që i referohet një prostitute të zakonshme si veprim i shturjes dhe *kedeshah* si veprim i një riti shenjtërues, që bën persona – prostituta në kërkim të pranimit të zotave, një realitet i zakonshëm i kulturës së popujve fqinj me popullin e Izraelit.

Në librin e Eksodit, një prej pesë librave të ligjit *Torah*, tregohet që populli kananeas, një prej popujve fqinj, kishte si kult qendror kultin e pjellorisë. Në

²Ky ishte veprimi i veçantë që i kushtohej Zotit si pjesë e flijimit. Ishte një ritual i ndjekur nga priftërinjtë, profetët, mbretërit të cilët vajoseshin me vaj dhe shenjtëroheshin për të kryer detyrat e ngarkuara. Mesia është vajosur mbi të gjithë, duke patur mbi vete autoritetin e të tre të parëve njëkohësisht. Në ungjijtë e Mateut, Markut, Lukës dhe Gjonit si edhe te Letra e Apostujve theksohet se në të (Mesinë) janë përmbushur të gjitha profecitë e lashta, Jezusi nga Nazareti është Mesia, Shpëtimtari që duhej të vinte. Sipas fjalorit biblik vetë emri Jezus, të cilit i atribuohet roli i Mesisë (hebraisht Jehoshua) do të thotë Perëndia shpëton.

³ Mendojmë që kjo shprehje ka ngacmuar Migjenin si njeri dhe teolog ashtu si edhe në krijimet e veta letrare.

⁴ Ungjilli sipas Lukës 8:1-2, Bibla, Diodati i Ri, ABS Tiranë, 2000.

⁵ Ungjilli sipas Markut 15:40, 47, Bibla, Diodati i Ri, ABS Tiranë, 2000.

⁶ Ungjilli sipas Markut 16:1-3, 9, Bibla, Diodati i Ri, ABS Tiranë, 2000.

Shëmbëlltyra e Maria Magdalenës biblike në figurën e gruas-prostitutës...

respektim të këtij kulti ata kryenin veprime, një formë të magjisë, me qëllim shenjtërimin. Ishte një praktikë e zakonit e kulturës së atëhershme, që karakterizohej nga bashkimi midis mashkullit dhe femrës në një vend të shenjtë në tempull, midis mbretit dhe priftëreshës apo edhe priftit dhe një të zgjedhure që, përmes aktit seksual i paraprarinin pjellorisë dhe begatisë.

Ky akt quhej i shenjtë (ndryshe prostitucion i shenjtë), sepse kryhej në tempull për qëllime shenjtërie dhe personat, që e kryenin cilësoheshin si të shenjtë (ndryshe prostitutë i/e shenjtë). Kështu dikotomia “kurvë” dhe “e shenjtë” ishte diçka e zakonit dhe jo paradoksale në këtë kulturë. Ligji i profetit Moisi e ndalonte praktikën e prostitucionit të shenjtë dhe këtij akti i referohet te libri i *Ligjit të Përtërirë* 23:17:

Nuk do të ketë asnjë grua që të merret me kurvëri “kedeshah” midis bijave të Izraelit, dhe nuk do të ketë asnjë burrë “kadesh” që të merret me kurvëri midis bijve të Izraelit. Në shtëpinë e Zotit, Perëndisë tënd, nuk do të çosh shpërblimin e një kurve “zonah”, as çmimin e një qeni (prostituim meshkujsh, shënim), për asnjë kusht, sepse këto dy gjëra janë një ndyrësi për Zotin, Perëndinë tënd.

Koncepti “prostitucion i shenjtëruar” duket të jetë huazuar nga Bodleri në meditet e tij te *Mon Coeur mis a nu: Çfarë është prostitucioni i shenjtë?* – reflekton Bodleri, - *Eksitim nervor. Mistikë e paganizmit*. Më pas, duke u bazuar në konceptin e dashurisë së pashtershme, për të cilin referuesi i natyrshëm është Zoti, ai pohon që edhe prostituta vepron ngjashmërisht, sepse ajo shndërrohet në një rezervuar dashurie, që nuk shteron dhe prej të cilit pijnë të gjithë. Për Bodlerin dashuria në thelb të saj, përveç adhurimit, ka sakrificën dhe prostituimi në vetvete është një sakrificë.⁷

Në një linjë të ngjashme mendimi, që buron nga kultura e lashtë hebreje dhe e përthyer në mendimin modernist francez të shekullit XX frymon motivi migjenian në projektimin e karaktereve të grave⁸, që janë cilësuar si kurva,⁹ madje kurva të shenjta! Motivi erotik përqendrohet në figurën e gruas, e cila dyzohet midis “prostitutës” dhe “të shenjtës-Madonës”¹⁰, midis imazhit të shenjtërisë së përdhosur

⁷ Baudelaire Charles, *Mon coeur mis à nu: journal intime*, (1887) <http://www.bmlisieux.com> Në këto meditime Bodleri shtyhet më tej duke e paralelizuar dashurinë femërore me dashurinë shtazarake, ndërsa i referohet tërheqjes që gratë kanë ndaj kafshëve si maceve, qenve etj. Ndoshta edhe kjo ka qenë një nxitje mendimi fragmentar te Migjeni kur përmend vetëm në një shprehje te skica *Urime për 1937: ... si bani Greta Garbo në filmin ‘Mbretnesha Kristina’ kur shijoi dashurin shtazore (desha të them hyjnore, por njësjaj asht)....*

⁸ Sjellim në vëmendje që figura e femrës në letërsinë e Migjenit shfaqet në të gjitha dimensionet e saj: si vajzë, grua, nënë dhe të gjitha figurat i lidh dhe i tjetëron një motiv, dashuria.

⁹ Është interesant fakti që edhe në Shkrimet është theksuar nga Krishti fakti që prostitutat (kurvat) ishin më të shpejta për t’u penduar dhe besuar se sa të tjerët, madje edhe në krahasim me udhëheqësit fetarë, që cilësoheshin si të drejtë dhe më pranë shenjtërisë!

¹⁰ Dikotomia virgjëreshë-kurvë kërkon që figura biblike e Maria Magdalenës-kurvë të vendoset përballë figurës biblike, Maria-virgjëreshë. Sipas tekstit biblik Maria Magdalena

dhe shëmbëllimit tokësor të shenjtëruar. Këtë raport e gjejmë sa të shpalosur eksplicikisht, aq edhe të maskuar e të ndërthurur në nivelet simbolike, vetëdijshëm të përzgjedhur nga autori ynë.

Te novela *Historia e njënës nga ato kemi tregues*, që janë shprehur qartë: *Rreth emnit Luke, veçanërisht rreth trupit të saj, ishte krijue njëfarë aureole (nimbusi) si rreth krenave të shejtënve... Aq sa ndonjerit i vinte keq që e quejnë kurvë dhe mundoheshin ta zbusnin kuptimin tue i thanë prostitutë, grue publike... Fjala kurvë ishte për të një disonancë e vrazhdë me melodinë harmonike, që premtonte Lukja... E Lukja e mirë, e Lukja e mshirplotë – se ajo ishte njëllë hyjneshe... Dhe fantazia e të rijve krijon aureolë shejtënsh rreth trupit të një grueje që shitet...*

Kjo është prej *Novelave të Qytetit të Veriut*, ku Migjeni regjistron historinë e njëres nga ato, Lukes, por në letërsinë e tij ato janë shumë, pavarësisht emrit që mund të jetë: Luke, Leze, nëna e Lilit, gruaja e çmendur që vallëzon në qytet, gruaja e melodisë së këputur apo zonjusha e bukur dhe me hir e lokalit. Secila prej tyre mund të jetë një prej *motrave legjitime të Lukes*. Ndoshta mund të jetë edhe ndonjë malësore, që zbret në qytet (ashtu si Lukja dikur!), ndonjë Dile që mosha i dikton shpërthimin për dashuri ose edhe ndonjë Hajrije apo Age që, nën mbulesën a veshjen s'mund të fshehin ndjesitë e tyre femërore për dashuri.

Te këto të fundit treguesit që orientojnë drejt një erotizmi mendërisht të shfrenuar janë të nënkuptuar.

Në dhomë e gjet Hajrijen të veshun dhe të goditun “allafranga”, me diçka si kapelë në krye, dhe tue ecë “mbas modet”. Bukuria e trupit të saj vizohej bukur ndër rrobe të shtërngueme dhe pozat e saj ishin ngacmuese... Osja, tue murmurue si qen i tërbuem, doli nga dhoma dhe vetëm iu merreshin veshit fjalët: “si kurvë... si kurvë.”¹¹

Sa fort Dila që i ndjen të 17 vjetët në vete! Kur në tkapërthyemit e dëshirës, ven shplakët në krye dhe ma fort shtrihet, ndjen si ndër veshë dhe ndër tamtha i rreh gjaku me rrjedhje të forta dhe e ban me i ndie dhe me dishrue ma tepër. Atëherë Dila mbyll sytë. Ashtu me sy mbyllë pret diçka. Buzët e saj të lagta e të çeluna përgjysë i terte fladi i lehtë...¹²

Edhe Agia mendon me vete pse mos me ardhë në shtëpi ditën ku asht ajo vetëm...atëherë bash duhet të vijë, i thotë një ndjesijë, diku thellë e mfsheun, nga e cila Agen, zojës së ndershme të filanit e të filanit, i vjen ndoht. Por ndjesia e mfshehun ia pushton trupin e ri...¹³

ishte prostitutë e penduar, e kthyer nga rruga e saj mëkatore dhe e falur nga Krishti. Dhe në gjithë ndryshimin e saj nuk ka qoftë edhe një moment të regjistruar të përfshirjes së saj në ekstaza seksuale. Duket që ka një ndarje të thellë ndryshimi midis asaj që ishte më parë në jetën e saj seksuale dhe asaj që erdhi më pas si pasojë e pendimit, duke e krahasuar atë me virgjëreshën, përndryshe shenjtoren Mari, nënën e Krishtit.

¹¹ *Të çelen arkapijat*, te Migjeni, *Vepra*, Cetis Tirana, 2002.

¹² *Puthja e cubit*, te Migjeni, *Vepra*, Cetis Tirana, 2002, f. 123.

¹³ *Studenti në shtëpi*, në Migjeni *Vepra*, Cetis Tirana, 2002, f. 143.

Shëmbëlltyra e Maria Magdalenës biblike në figurën e gruas-prostitutë...

Me kaq pak Migjeni krijon një skenë ku seksi është i pranishëm edhe pa u përmendur; nuk i drejtohet drejtpërdrejt, por përmes një gjuhe të nënkuptuar. *Si ka për t'u kthyer në malsi nëpër terr?... nuk i dron bubazhelat si qytetarët, por njerëzit... Njerzit i ka ajo frigë. E pse? Pse asht e re dhe e bukur... E ai njeri q'aty, ai që tash po ec përpara saj, peshon shumë randë në kujtesën e malsores, e cila kuqet, kuqet e skuqet nga turpi.*¹⁴

Studiuesi Robert Elsie në studimin *Rruga drejt modernitetit dhe koha e artë e letërsisë shqiptare* të publikuar në shqip dhe në anglisht ka vërejtur që poezia dhe frazat në letërsinë e Migjenit janë plot me figura grash¹⁵, shpesh herë prostituta të mjeruara. Për Migjenin, seksi ishte vuajtje e mjerim, një përrallë mbi varza të fyeme / me faqe e buzë të thithna se mjerimi tërbohet në dashuni epushore /... kapërthehen ndjenjat me fuqi shtazore, /kafshojnë, përpijnë, thithen, puthen buzët e ndragta / edhe shuhet uja, dhe fashitet etja / n'epshin kapërthyes, kur mbytet vetvetja.¹⁶

Çështja erotike në këtë rast nuk është e parë si çështje mishtore, *Tjerët e bajnë këtë punë për qejf, e na e bajmë për hall!*¹⁷, por një çështje shpirtërore, përmes të cilës Migjeni tenton të japë esencën, që e përafron më shumë me ndikimin bodlerian të konceptit të prostitucionit të shenjtëruar, të bazuar në sakrificën e

¹⁴ Kështu “mbyllet” skica *A do qymyr zotni?* për të vazhduar historinë te novela *Historia e njanës nga ato: Një ditë të kristaltë dimni, kur frynte veriu dhe acari kish ngri vesën, Lukja zbriti në qytet. Biografia e saj deri m'at ditë asht e thjeshtë, por plot vuezje si e të gjitha femnave të malsis. E jeta në qytet, prej së largu, dukej e bukur. Sidoqoftë buka fitohet; sidomos kur ke rininë dhe shëndet. Po kur Luka bani dështimin e parë, pau se për ato që s'kanë, jeta gjithkrah asht e njëllojtë....* Shih për më shumë Migjeni *Vepra*, Cetus Tirana, 2002, f. 91 dhe 155.

¹⁵ Është interesant një fakt i identifikuar në ungjijtë e krishterë, ku prania e grave gjatë misionit të Krishtit është e madhe krahasuar me karaktere të tjerë që gjallojnë në të: Vjehrra e Simonit që u shërua nga ethe; e veja e Nainit që kërkoi shërimin e të birit; Maria Magdalena, mëkatarja që vajosi këmbët e Krishtit; gruaja me fluks gjaku; e bija e Jairit që u ringjall, gruaja e paralizuar; gruaja e ve që dha një të dhjetën; gruaja nga Samaria; gruaja që shkeli kurorën; gruaja greke me origjinë sirofenikase, si edhe gratë që i shërbenin Jezusit qoftë duke e ndjekur, qoftë përmes veprave dhe mbështetjes ekonomike. Gratë ishin protagoniste gjatë jetës dhe misionit të Krishtit në të tre momentet kyç: e lindjes, e kryqëzimit dhe e ringjalljes; *Dhe ndodhi që, sapo Elizabeta dëgjoi përshëndetjen e Maries, fëmija i kërceu në bark...* (Ungjilli sipas Lukës 1:41); *Aty ishte edhe Ana, një profeteshë [...] edhe ajo erdhi në atë moment, lavdëroi Zotin dhe u fliste për këtë fëmijë të gjithë atyre që prisnin çlirimin në Jeruzalem.* (Ungjilli sipas Lukës 2:36, 38); *Ishin aty edhe shumë gra që vërenin nga larg* (ngjarja e kryqëzimit, shën. V.A.) (Ungjilli sipas Mateut 27:55); *Tani në fund të së shtunave, kur po zbardhte dita e parë e javës, Maria Magdalena dhe Maria tjetër shkuan për të parë varrin. [...] Por engjëlli, duke iu drejtuar grave, u tha atyre: 'Mos kini frikë se unë e di që ju kërkoni Jezusin' [...] Dhe, ndërsa po shkonin për t'u thënë dishepujve, ja Jezusi u doli përpara dhe u tha 'Tungjatjeta!' Atëherë ato u afruan, i rrokën këmbët dhe e adhuruan.* (Ungjilli sipas Mateut 28, 1-9).

¹⁶ *Vargjet e Lira*, te Migjeni *Vepra*, Cetus Tirana, 2002.

¹⁷ *Bukën tonë të përditshme falna sot...,* te Migjeni *Vepra*, Cetus Tirana, 2002, f. 181.

prostituimit për shkak të dashurisë. Nuk ka rëndësi forma apo mënyra që zgjedh të sakrifikosh, mjafton që ajo të jetë një sakrificë që t'ia vlejë, edhe sikur kjo të kërkojë tejkalim të vetvetes.

Në novelën *...Bukën tonë të përditshme falna sot...* nëna e Lilit prostituon në kushtet dhe rrethanat, jo thjesht të varfërisë dhe skamjes së tejskajshme, por për shkak të dashurisë për të birin që të kishte jetë. Kështu veprimi, pavarësisht se konsiderohet si çnderues justifikohet përmes motivit sublim të dashurisë sakrifikuese. Akti i kësaj nëne prostitutë bëhet i shenjtë në momentin e zgjedhjes së saj (kundër vullnetit të natyrshëm) të sakrifikojë për hir të dashurisë. Këtu merr kuptim simbolika e dashurisë mëmësore si dashuri hyjnore.¹⁸

Në këtë veprim njerëzor që merr përmasa hyjnore ngjizet edhe ironia migjeniane: për shkak të dashurisë flijuese për të birin, ajo del, jo vetëm kundër një mentaliteti të rrënjësor për këto “lloj punësh”, por edhe kundër vetvetes, duke zgjedhur të shkojë me të tjerë; i duhet të dojë *ndryshe* shumë të tjerë që të kompensojë “materialisht” nevojën e të birit për të bërë të mundur që ai të jetojë. Madje, në një moment, kjo “lojë” edhe i pëlqen: *Ajo iu avit pasqyrës, buzëqeshi dhe i pëlqeu vetvetja.*

Çështja shpirtërore e këtij akti te figura e Lukes në *Historia e njënës nga ato* është po kaq e shenjtë, por dallueshëm në qasje. Mëkati i saj nuk llogaritet si mëkati i një kurve të zakonshme, sepse shenjtëria e saj buron nga dashuria që ajo ka pasur për shumë, po shumë meshkuj (krahaso me tekstin biblik për figurën e Maria Magdalenës *sepse ka dashur shumë...*). Madje, sipas autorit, ajo është bërë edhe pengesë që këta djem të mos bëhen preh e një mëkati më të ndyrë: *E në dhomën e Lukes treteshin energjitë e të rijve. Të mos u treteshin aty, do treteshin ngjeti, në mënyrë të panatyrshme*¹⁹, *të rafinueme, të shpikun vetveti, tue u bashkue intelektit me epsh.* Pikërisht për këtë edhe i janë falur mëkatet, ndaj edhe figura e Lukes krahasohet me atë të Maria Magdalenës biblike që si “prostitutë” shenjtërohet dhe shndërrohet në një “madonë” me “*aureolë shejtënsh*”.

Sipas referencës biblike Maria Magdalena u radhit midis atyre, që u quajtën ndjekësit e Krishtit, madje pati privilegjin të ishte dëshmitarja e parë e ringjalljes së tij. Në tekstin tonë kemi një kthesë në jetën e Lukes, më mirë të themi në personin e Lukes, sepse në kërkim të një zemre të humbur si veten për të krijuar një vatër të ngrohtë familjare, ajo bëhet “*shembull dhe grave të kojshive*” duke i ruajtur nderin të shoqit dhe duke mos shkuar me të tjerë meshkuj. Në fakt, jeta e mëparshme ishte kthyer tanimë në një tmerr për Luken, edhe pse i duhej të

¹⁸ Sepse edhe sipas mendimit biblik, dashuria e madhe hyjnore e Perëndisë ishte që e deshi aq botën sa sakrifikoi birin e tij Krishtin për njerëzit, pasi ai ishte mishëruar jo natyrshëm me natyrën e vet si hyjni. Shih Ungjilli i Gjonit 3:16.

¹⁹ Në konceptin biblik mëkati është gjë e panatyrshme, opozita e natyrës së krijuar nga Perëndia. Kurse erosi është “dhurata”, që Perëndia i dha njeriut në momentin e krijimit: *Për këtë arsye njeriu..., do të bashkohet me gruan e tij dhe do të jenë një mish i vetëm.* Shih librin e Zanafillës 2:24, Bibla, Diodati i Ri, ABS, Tiranë, 2000.

Shëmbëlltyra e Maria Magdalenës biblike në figurën e gruas-prostitutë...

“duronte” përdhunimet e ftyrës së zezë e të mbrapshtë të të shoqit në shtrat..., të paktën, tanimë ishte vetëm një i tillë!

Por, përkundër figurës së Maria Magdalenës, ku, sipas historisë biblike besimi e shpëtoi dhe i dha paqe (‘Besimi yt të shpëtoi; shko në paqe!’²⁰), në rastin e Lukes martesë nuk e shpëtoi, por ia rëndoi mjerimin deri në çmenduri. Këtu qëndron tragjedia, jo vetëm e Lukes, por e të gjitha karaktereve të grave prostituta në letërsinë e Migjenit, në pikëprerjen ku përplasen dy tekstet, ai burimor biblik dhe ai i përfutur migjenian, andaj edhe ky i fundit mbart tension ironik deri në ngërdheshje palaçoje, që e bën thellësisht tronditës. *Dhe Lukja, me ftyrë të nxime nga vëjtja, me ata sy të marri me at hi hi hi, shko në çmendinë. Në çmendinë me at hi hi hi ka me tregue historinë e jetës së vet*²¹ - një jetë e fikun, një jetë e shterun, / shpirt i molisun, zemër e therun...²²

*Dhe Lukja, me ftyrë të nxime nga vëjtja, me ata sy të marri me at hi hi hi, shko në çmendinë. Në çmendinë me at hi hi hi ka me tregue historinë e jetës së vet*²³ - një jetë e fikun, një jetë e shterun, / shpirt i molisun, zemër e therun...²⁴

Është tensioni midis realitetit të shpëtimit në tekstin biblik dhe humbjes në çmenduri në tekstin migjenian, prej nga ku buron revolta e të ndjerit i tradhtuar dhe mirëfilli ndjen tradhti; është tensioni i fatit të paracaktuar biblik, që dikë e çon në një fund të lumtur e të paqte dhe dikë tjetër në fund të çmendur e fatalist, prej nga ku buron ngërdheshja dhe zgërdhitja *hi hi hi*.... Dhe kjo tragji-komedi e protagonistes së Migjenit e nis zanafillën në momentin e ndryshimit esencial dhe ekzistencial të jetës së këtyre dy figurave femra tipike, të cilat kanë dashur shumë.

Si përfundim, nëse bota i paragjykon duke i veçuar si të përjashtuara nga shoqëria femrat-kurva apo gratë publike, Migjeni zgjedh që këtë veçim ta kthejë në një cilësi të veçantë, duke i shenjtëruar.²⁵ Pikëprerja e këtyre karaktereve migjeniane me shëmbëlltyrën e Maria Magdalenës biblike qëndron në shndërrimin, që pësojnë figurat për shkak të dashurisë. Për hir të dashurisë ato kanë “shpëtuar” shumë, ndaj edhe u është falur shumë, pavarësisht zgjedhjes që kanë bërë. E megjithatë, nën ndikimin e mendimit modern mbi konceptin e lashtë të “prostitucionit të shenjtëruar” Migjeni përpiket të njësojë veprimin e prostitucionit me ndjenjën e dashurisë në momentin kur kjo sakrificë kryhet për

²⁰ Vërejmë një ndryshim me një shembull tjetër biblik të një gruaje, që ka shkelur kurorën, së cilës i falen mëkatet, por nuk i cilësohet paqja: *Kush nga ju është pa mëkat, le ta hedhë i pari gurin kundër saj! Jezusi atëherë u ngrit dhe duke mos parë tjetër përveç gruas, i tha: ‘O grua, ku janë ata që të paditnin? Askush nuk të dënoi?’ Dhe ajo iu përgjigj: ‘Askush Zot.’ Atëherë Jezusi i tha: ‘As unë nuk të dënoj; shko dhe mos mëkato’* Shih Ungjilli sipas Gjonit 8:10-11, Bibla, Diodati i Ri, ABS Tiranë, 2000.

²¹ *Historia e njëjës nga ato te Migjeni Vepra*, Cetis Tirana, 2002, f. 160.

²² *Baladë qytetse te Migjeni Vepra*, Cetis Tirana 2002, f. 19.

²³ *Historia e njëjës nga ato, te Migjeni Vepra*, Cetis, Tirana, 2002, f. 160.

²⁴ *Baladë qytetse, te Migjeni Vepra*, Cetis, Tirana, 2002, f. 19.

²⁵ Sipas mendimit të krishterë shenjtërim është cilësia e të qenit i veçuar nga ajo çfarë mund të quhet e zakonshme, cilësi që e mbartnin vetëm shenjtoret, profetët, të zgjedhurit dhe çdo subjekt apo objekt tjetër hyjnor.

shkaqe sublime. Kështu, gratë-kurva shihen dhe serviren si “madona të shenjtë” në letërsinë e tij. Por, nëse në tekstin burimor shëmbëlltyra biblike pëson ndryshim pozitiv si pasojë e paqimit dhe pranimet nga Krishti me shprehjen e mirënjohur të Krishtit ‘*Shko në paqe! Besimi yt të shpëtoi!*’, në tekstin migjenian, derivimi nga ky moment i çon karakteret e tij drejt tragjedisë fatale të ekzistencës së tyre.

BIBLIOGRAFI

- A. Nikolla, *Baudelaire-Rimbaud-Migjeni dhe gjeneza e poezisë moderne shqipe*, Globus R, Tiranë, 2007.
- A. Kapurani, *Migjeni ose Parathënia e dyzuar*, Onufri, 2010.
- Bibla e Studimit*, ABS, Tiranë, Tetor 2009.
- Ch. Baudelaire, *Mon coeur mis à nu: journal intime* (1887) <http://www.bmlisieux.com>
- Diodati i Ri *Bibla*, ABS Tiranë 2000.
- R. Elsie, *Historia e letërsisë shqiptare*, Dukagjini, Pejë, 2002.
- K. Anderson, *Where to Find it in the Bible*, Nashville, T. Nelson Publishers, 1996.
- M. Ferber, *A Dictionary of Literary Symbols*, Cambridge University Press, New York, USA, 1999.
- Migjeni, *Vepra*, Cetis, Tirana, 2002.
- R. Elsie, *Parathënie “An elusive eagle soars” antologji e poezisë moderne shqipe*, “Forest Books”, London & Boston, 1993.
- Sh. Sinani, *Teksti biblik në veprën e Migjenit*, “Studime filologjike”, 3-4, 2012.
- Y. Chevrel, *Letërsia e krahastuar*, Albin, 2002.